



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 236, datë 26.11.2021

MBI

ZGJATJEN E AFATEVE TË PËRCAKTUARA NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 171, DATË 16.08.2021, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR, “ALBGAZ” SH.A.”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 144/6 prot., datë 23.11.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi zgjatjen e afateve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.08.2021, “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “ALBGAZ” sh.a.”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 171, datë 16.08.2021, ka vendosur:
 1. Të miratojë Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “ALBGAZ” sh.a., me kushtin që shoqëria brenda 3 muajve ta depozitojë atë në ERE të përditësuar me përcaktimet sipas kërkesave të pikës 5, pikës 6 dhe pikës 15, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.05.2017.
 2. Mosplotësimi i kushtit sipas përcaktimeve të pikës 1, përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 53/8 prot., datë 16.11.2021, shoqëria “ALBGAZ” sh.a. ka depozituar kërkesën për shtyrjen me 3 (tre) muaj të afatit të përcaktuar në pikën 1, të vendimit të sipërcituar, duke u shprehur se ka marrë të gjitha masat për të plotësuar kushtet e vendimit dhe aktualisht është në proces konsultimi me aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje.

- Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.*”

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 3 (tre) muaj, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, afatin e përcaktuar në pikën 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.08.2021, “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “ALBGAZ” sh.a.”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI